

Kryetarja e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Besa Ademi, në bazë të nenit 88 paragrafi (1) dhe (3), nenit 39 paragrafi (11) të Ligjit për gjykatat, Rregullores gjyqësore dhe Rregullores së punës të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut ("Gazeta Zyrtare e RMV" nr.14 të datës 20.01.2022), më 06.10.2022, miratoi këtë:

VENDIM
për ndryshimin dhe plotësimin e
Orarit vjetor
të punës së Kryetarit dhe gjyqtarëve në Gjykatën Supreme të
Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022, 03-Su.nr.57/22 të datës
26.01.2022 dhe 03-Su.nr.57/22-1 të datës 14.07.2022

Neni 1

Në kreun III Sektori i veprave civile

Pika C.I. Në Sektorin e veprave civile caktohen gjyqtarët **NDRYSHON SI VIJON:**

„C.I Në Sektorin e veprave civile caktohen gjyqtarët:

1. Besa Ademi
2. Vasil Gërçev
3. Vlladimir Stojanoski
4. Jelica Kërstevska
5. Snezhana Gjorgjieska Zekirija
6. Isamedin Limani
7. Shpend Devaja
8. Nake Gerorgiev “

Neni 2

Në kreun III Sektori i veprave civile

Pika C.III **NDRYSHON SI VIJON:**

„C.III. Këshilli i parë prej pesë gjyqtarëve, që do të veprojnë për lëndët Rev1, Rev2 dhe Rev3, do të formohet në mënyrën si vijon:

1. Snezhana Gjorgjieska Zekirija - kryetare
2. Vasil Gërçev – anëtar
3. Vlladimir Stojanoski - anëtar
4. Isamedin Limani - anëtar
5. Anëtari i pestë në këshillin e parë do të jetë nga dy gjyqtarët anëtarë të këshillit të dytë që do të rrotojnë sipas vendimit për zgjedhje.

Kryetarja e këshillit, gjyqtarja **Snezhana Gjorgjieska Zekirija** nuk obligohet me lëndë“.

Neni 3

Në kreun III Sektori i veprave civile
Pika **C.IV NDRYSHON SI VIJON:**

„C.IV. Këshilli i dytë prej pesë gjyqtarëve që do të veprojnë për lëndët Rev1, Rev2 dhe Rev3, do të formohet në mënyrën si vijon:

- 1. Shpend Devaja – kryetar**
- 2. Jelica Kërstevska – anëtare**
- 3. Nake Georgiev - anëtar**
- 4. Anëtari i katërt në këshillin e dytë do të jetë nga tre gjyqtarët anëtarë të këshillit të parë që do të rrojnë sipas vendimit për zgjedhje.**
- 5. Anëtari i pestë në këshillin e dytë do të jetë nga tre gjyqtarët anëtarë të këshillit të parë që do të rrojnë sipas vendimit për zgjedhje.**

Kryetari i këshillit, **gjyqtari Shpend Devaja** nuk obligohet me lëndë.

Gjyqtarët që do të marrin pjesë si anëtar i pestë në këshillin e parë respektivisht si anëtarë i katërt dhe i pestë në këshillin e dytë nuk do të referojnë lëndë në ato këshilla.“

Neni 4

Në kreun IV Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm
Pika **Ç. I. NDRYSHON SI VIJON:**

„Ç.I. Në këtë Sektor caktohen gjyqtarët:

- 1. Vasil Gërçev**
- 2. Vlladimir Stojanoski**
- 3. Mr. Faik Arslani**
- 4. Jelica Kërstevska**
- 5. Dr. Xhemali Saiti**
- 6. Snezhana Gjorgjieska Zekirija**
- 7. Isamedin Limani**
- 8. Afrim Fidani**
- 9. Dr. Mirjana Llazarova Trajkovska**
- 10. Mr. Safet Kadrii**
- 11. Nake Georgiev“**

Neni 5

Në kreun IV Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm
Pika **Ç. IV. PARAGRAFI (3) NDRYSHON SI VIJON:**

„Në rast të mungesës dhe pengesës dhe për shkaqe tjera të arsyetuara me kryetarët dhe anëtarët e këshillave do të zëvendësohen në mënyrë reciproke dhe për zëvendës anëtar caktohet edhe gjyqtari **Shpend Devaja** ose ndonjë gjyqtar që nuk ka marrë pjesë në asnjë fazë nga procedura e lëndës konkrete.“

Neni 6

Në kreun IV Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm
Pika **Ç. VI. NDRYSHON SI VIJON:**

„Për vendimmarrjen e ankesave kundër aktvendimeve të këshillit prej tre gjyqtarëve për kërkesat për mbrojtjen e të drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm në pajtim me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për gjykatat (neni 36-a), caktohet **këshilli prej pesë gjyqtarëve**, si vijon:

- 1. Snezhana Gjorgjieska Zekirija – kryetare**
- 2. Vasil Gërçev - anëtar**
- 3. Vlladimir Stojanoski - anëtar**
- 4. Mr. Faik Arslani - anëtar**
- 5. Jelica Kërstevska - anëtare“**

Neni 7

Në kreun IV Sektori për gjykim në afat të arsyeshëm
Pika **Ç. VIII. NDRYSHON SI VIJON:**

“**Ç.VIII.** Në rast të mungesës dhe pengesës dhe për shkaqe të arsyetuara, për zëvendës anëtar caktohet gjyqtarja **Cvetanka Periq** ose ndonjë gjyqtar tjetër që nuk ka marrë pjesë në asnjë fazë nga procedura e lëndës konkrete.“

A r s y e t i m

Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Orarit vjetor të punës së gjyqtarëve për vitin 2022 e miraton Kryetari i Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, për arsye që me certifikatë të Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 07 -56/1 të datës 15.09.2022 Mirjana Radevska Stefkova, gjyqtare e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut në zgjedhjet e realizuara më 14.09.2022 është zgjedhur për anëtare e Këshillit gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut nga radha e gjyqtarëve.

Zgjedhja e fundit të gjyqtarit për anëtar të Këshillit gjyqësor dhe pensionimet e kaluara të gjyqtarëve kontribuoi për zvogëlimin drastik të numrit të gjyqtarëve në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, që për momentin funksionon me 14 gjyqtarë përfshirë edhe Kryetarin e Gjykatës.

Gjendja e këtillë dukshëm erdhi në shprehje edhe në Vendimin për ndryshimin dhe plotësimin e Orarit vjetor të punës së gjyqtarëve për vitin 2022.

Nga arsyet e theksuara u imponua nevoja për angazhimin e disa gjyqtarëve si zëvendës kryetarë dhe anëtarë në këshillat, si dhe formimin përkohësisht të këshillave për lëndë konkrete me caktimin e kryetarëve dhe anëtarëve të këshillave nga radha e gjyqtarëve që nuk kanë marrë pjesë në asnjë fazë të procedurës.

Nevoja për formimin përkohësisht të këshillave për lëndë konkrete është për shkak të një numri më të madh të kërkesave për përjashtim të gjyqtarëve që kanë marrë pjesë në ndonjë fazë të kaluar nga procedura për të njëjtën lëndë.

Sipas ndryshimeve në përbërjen e këshillave, lëndët që me shpërndarje automatike u janë ndarë gjyqtarëve, kurse të njëjtat nuk janë referuar ose nuk është marrë vendim, automatikisht do të rishpërndahen përmes Programit AKMIS, në bazë të dispozitave nga Rregullorja gjyqësore.

Sipas ndryshimeve në përbërjen e këshillave, lëndët që gjenden në punë te gjyqtarët, kurse janë të referuara ose është marrë vendim, të përfundohen në të njëjtat këshilla.

Ky Vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit dhe do të zbatohet pasi të bëhet i plotfuqishëm.

**KRYETARE
E GJYKATËS SUPREME TË
REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT**

Besa Ademi

UDHËZIM: Sipas nenit 39 paragrafi (11) të Ligjit për gjykatat, kundër Vendimit, gjyqtari mund të parashtrojë ankesë në afat prej 3-tre ditësh pas pranimit të së njëjtit.

Dorëzuar:

- Gjyqtarëve
- Administratorit gjyqësor
- udhëheqësve të sporteve
- kontabilitetit
- Qendrës IT
- arkivit